

VENDIM
Nr.78, datë 14.12.2007

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.64, DATË 27.11.2007 TË BORDIT
TË KOMISIONERËVE “PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË KËRKESËS
SË SHOQËRISË “ENPOWER ALBANIA” SHPK, PËR LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E
NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË,
SI DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 9, pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 19, pika 3 të “Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 për miratimin e “Rregullores për procedurat e licencimit”, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 14.12.2007,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e pikës 2 të vendimit nr.64, datë 27.11.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, ta njoftojnë shoqërinë “Enpower Albania” sh.p.k.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta